



Banka Ekonomike, Prishtinë

Economic Bank, Prishtina



Ju mund të na kontaktoni në:

Adresa: Qafa 5a Prishtinë Tel/Fax: +381 38/248997, 243828, 247090


e-mail: bek@bekonomike.com, www.bekonomike.com

Filiala Prishtinë: tel.+fax.038/229497, 243828; Mitrovicë: tel.+fax.028/34700; Pejë: tel.+fax.039/34815;

Gjakovë: tel.+Fax.0390/24861; Prizren: tel.+Fax.0290/42234; Ferizaj: tel.+fax.0290/21260;

Gjilan: tel.+fax.0280/2060; Ekspozitura në Burim (Istog): Tel.+Fax.039/51339

Pamje nga Asambleja Themeluese e Akcionarëve
mbajtur më 28 Maj 2001 në Prishtinë



View from Founder Assembly of Shareholders
realised on 28.May.2001

Përmbajtja

1. Fjala përshëndetëse e Drejtorit Gjeneral	5
2. Vështimi i përgjithshëm i ekonomisë kosovare	7
2.1. Produkti i brendshëm bruto (GDP)	7
2.2. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore	8
2.3. Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet	9
2.4. Inflacioni	10
2.5. Tregëtia e jashtme	10
2.6. Punësimi	11
2.7. Sistemi bankar dhe financat	11
3. Vështrim mbi Bankën Ekonomike gjatë vitit 2003	15
3.1. Numri i llogarive të klientëve	15
3.2. Depozitat	16
3.3. Kreditimi	17
3.4. Qarkullimi i pagesave	19
3.5. Të ardhurat dhe shpenzimet	19
3.6. Zgjerimi	20
4. Raporti i Auditorëve të Pavarur	23
5. Pasqyrat Financiare	24
1. Të përgjithshme	27
2. Përmbledhja e politikave kontabël	28
3. Para në dorë dhe në banka	33
4. Balanci me Autoritetin Bankar të Pagesave të Kosovës	34
5. Huatë ndaj klientëve neto	34
6. Interesi akrual dhe llogari tjera të arkëtueshme	36
7. Aktive të qëndrueshme fikse	37
8. Aktive të paqëndrueshme	37
9. Detyrime ndaj klientëve	38
10. Interesi akrual dhe detyrimet tjera	39
11. Kapitali aksionar	39
12. Fitimi i pashpërndarë	40
13. Të ardhurat neto nga interesat	40
14. Të ardhura tjera operuese	41
15. Shpenzime tjera operative	41
16. Taksimi	41
17. Vlera e tregut dhe menaxhimi i riskut	42
18. Angazhime dhe detyrime të parashikuara	43
19. Transaksione me palët e ndërlidhura dhe përqëndrimet e ekspozimit	44
20. Pozicioni i monedhave	48
21. Analiza e maturiteteve të aktiveve dhe pasiveve	49
22. Pensionet	50
Këshilli drejtues	51
Drejtuesit	52
Bankat korrespondente	53

1. Fjala përshëndetëse e Drejtorit Gjeneral



Partnerë të nderuar,

Banka Ekonomike sh.a. Prishtinë u licencua nga BPK (Autoriteti i Bankave dhe Pagesave të Kosovës) më 28 maj 2001, ndërsa punën e filloi më 6 qershor të vitit 2001 si Bankë Komerçiale.

Banka gjatë periudhës së kaluar më se dy vjeçare ka zhvilluar aktivitetin në tregun kosovar në kushte të një konkurrence të fortë dhe arriti sukses të lakmueshëm.

Banka edhe vitin 2003 e perfundoi me një fitim të mire dhe zuri vendin e tretë ndër shtatë Bankat Komerçiale që afarojne në Kosovë. Në fund të vitit 2003 u tejkaluan të

gjitha parashikimet dhe parametrat e planifikuar siç janë:

- Rritja e depozitave, portfolios së huave, profitit neto (fitimit), e kështu me radhë. Edhe pse sektori bankier në Kosovë po zhvillohet në kushte të vështira ekonomiko - shoqerore dhe sociale, ai këto vite po shënon sukses.

Kjo është arritur fale vuarjes së Rregullave në pajtim me përvajtjet dhe standardet më të mira ndërkombetare, mbikëqyrjes së forte dhe përvojës së menaxhimit.

Banka Ekonomike, qysh në fillim të punës ka krijuar parakushte të nevojshme për punë të rregullt me klientët. Është e vetmja Bankë që prej fillimit të punës ka pas Software ONLINE. Kjo gjë në kushtet e Kosovës së pasluftës ka qenë përparsi e dukshme. Paralel me këtë ka aftësuar personelin për kryerjen e të gjitha punëve bankare për klientet e vete. Banka në fillim ka filluar punën me dy dege dhe gjer në fund të vitit 2003 ka hape degë të reja në të gjitha qendrat regjionale të Kosovës dhe 9 nëndege tjera. Me këtë, banka ka rumbullaksuar aktivitetet e parapara në planin e zhvillimit para kohe.

Faza e pare ishte faza e zhvillimit dhe stabilizimit të bankës në qendrat regjionale, pikat doganore etj. Ne planin e ardhshëm parashihet zgjerimi në qendrat tjera. Perveq zgjerimit të rrjetit në Kosovë, Banka krijoi lidhje dhe marrëdhënie të mira me bankat korrespondente, nëpërmjet të cilave realizoi qarkullim të pagesave, aftësimin e personelit, këmbimin e përvojave dhe zgjerimin e produkteve bankare, etj.

Zgjerimi i rrjetit brenda Kosovës dhe jashte ndikoi pozitivisht në pagesat ndër-bankare në Kosovë dhe jashtë. Nëpërmjet bankës tone, në vitin 2003, klientët transferuan mjete në shume prej 188 mil.euro, prej kësaj shume mbi 92 mil.euro transferta ndërkombetare. Banka permanent e zgjeron lepezen me produkte te reja.

Banka Ekonomike në tregun financiar të Kosovës ka krijuar një imazh si bankë stabile si për aksionarët ashtu edhe për depozitaret. Banka ka mbeshtet biznesin privat, si të ekonomisë familjare, ndermarrjeve të vogla e të mesme

Banka Ekonomike, Prishtinë

dhe individet. Kreditimi është here sipas kushteve të tregut duke shfrytëzuar mundësite maksimale për përmiresimin e kushteve. Me rritjen e depozitave dhe forcimit të ndermarrjeve edhe shumat e kredive u rriten, kushtet u përmiresuan. Kjo tendence do të vazhdon edhe në të ardhmen. Kthimi i huave është shumë i mirë. Banka për çdo hua ka siguruar kolateral sipas standardeve dhe Rregullave ne fuqi.

Valuta konvertibile e cila aplikohet në Kosovë është komponent e rëndësishme për depozitarët, aksionarët dhe afarizmin e suksesshëm të bankes.

Banka Ekonomike, që nga rilicencimi e në vazhdimsi deri në fund te vitit 2003 ka arritur rezultate të mira financiare dhe zgjeruar rrjetin e Bankës me degë dhe nëndegë duke iu falenderuar bashkepunimit të ngusht dhe profesional të Asamblesë së Aksionareve, Keshillit Drejtues dhe komisioneve të tij me menaxhmentin e Bankës.

Organet qeverisese të Bankës kanë zhvilluar aktivitetin e tyre mbi standardet e përcaktuara me Rregulloren mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Bankave, Rregullave të BPK-se dhe dispozitave të Statutit të Bankës Ekonomike. Banka çdo vitë e bën auditimin nga një auditor i jashtëm. Banka pensionistëve nuk ju merr provizionin.

Në fund dëshiroj ti falenderoj të gjithë ata që kontribuan në afarizëm të suksesshem të bankës.

Hajrullah Zaiti,
Drejtor i përgjithshëm

2. Vështrim i Përgjithshëm i Ekonomisë Kosovare

Kosova pas luftës në vitin 1999 trashëgoi një ekonomi të shkatëruar, si rrjedhim i menaxhimit të keq që nga viti 1989 dhe djegieve e plaçkitjeve që iu bënë gjatë luftës. Prona shoqërore ishte e vjetruar nga teknologjia dhe mënyra e menaxhimit, ndërsa prona private i pësoi shkatërrimet më të mëdha.

Pas luftës, Kosova nën administrimin e UNMIK-ut dhe në bashkëqeverisje me institucionet e zgjedhura të Kosovës, ka patur progres në rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit, veçanërisht në zhvillimin e sektorit privat të ekonomisë dhe krijimit të sistemit të qëndrueshëm bankar. Mirëpo, niveli i zhvillimit ekonomik nuk ishte i mjaftueshëm për zbutjen e papunësisë dhe rritjen e standardit të punëtorëve. Kosova në vitin 2003 realizoi prodhimin e përgjithshëm për kokë banori ndër më të ultin në regjion, ndërsa përqindjen e papunësisë ndër më të lartën (55-60%) me tendencë keqësimi. Mbulesa e importit të mallrave dhe shërbimeve me eksport është shumë e ultë (3,7%) për shkak të mvarësisë së ekonomisë kosovare nga importi, që tregon zhvillimin e ultë global dhe struktural të ekonomisë.

Fillimi i procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në maj të vitit 2003 ishte shpresëdhënës për investimet e reja në ekonominë kosovare, mirëpo bllokimi i tij pas shpalljes së tenderit të tretë gjatë vitit 2003 dhe moszgjidhja e statusit të Kosovës ndikuan në mosinteresimin e investitorëve të vendit dhe të huaj për deponime investive në Kosovë.

Vetëm buxheti i Kosovës, në këto rrethana, shënoi suficit.

Pagat e ulta të punëtorëve në sektorin publik (arsimi, shëndetësia, policia, etj.), e privat, pensionet e ulta dhe mosaktivizimi i disa ndërmarrjeve shoqërore, krahas investimeve të vogla në industri e bujqësi, ndikuan në rënien e aftësisë blerëse të popullsisë dhe qarkullimit të mallrave e shërbimeve.

Rënia e akumulimit në sektorin privat të ekonomisë dhe rënia e standardit të punëtorëve rezultoi me rritjen e varësisë së tyre prej kredive të bankave komerciale dhe mikroinstitucioneve financiare në Kosovë.

2.1. Produkti i brendshëm bruto (GDP)

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë parashikoi për vitin 2003 një rritje të Produktit të brendshëm bruto prej 5,90% në krahasim më vitin 2002. Ndërsa, në bazë të raportit më të ri të Komisionit Evropian, për ekonominë e vendeve të Ballkanit, produkti i brendshëm bruto për kokë banori, ka shënuar rënie për 25% (940 euro në vitin 2002 e 700 në 2003).

Ky ndryshim në rënie, në vend të rritjes së parashikuar, është pasojë e disa faktorëve: mungesës së prodhimit vendor, investimeve të huaja dhe ngadalësimit të procesit të privatizimit dhe zgjidhjes së statusit të Kosovës, si

Banka Ekonomike, Prishtinë

dhe rënies drastike të donacioneve të bashkësisë ndërkombëtare.

Me nivelin e GDP-së për vitin 2003, Kosova mbetet vendi më i pazhvilluar në rajonin e Ballkanit dhe vendi në të cilin GDP-ja është në rënie me shpejtësi të madhe. Në bazë të këtij raporti, secili vend tjetër në rajon është duke shënuar rritje graduale të GDP-së. Bosnja ka arritur në 1400 euro, Shqipëria në 1600, IRJM dhe SMZ në 2000, ndërsa Kroacia është në kreun e tabelës në 5400 euro.

Struktura e Produktit të brendshëm bruto tregon se në formimin e tij kanë ndikuar tre faktorë kryesorë: asistenca e huaj, dërgimi i mjeteve dhe importet:

Produkti i brendshëm bruto

Përshkrimi / periudha	2000	2001	2002	2003*
GDP (në mil. Euro)	1.338	1.582	1.687	1.825
GDP për banorë në euro	770	851	866	917
Rritja në përqindje	100	10,5	1,8	5,9
Pagat (dërgesat) e punëtorëve	550	600	700	728
Ndihma nga jashtë	1.212	1.084	772	721
Kont.direkt i ndihm.ndërk.	373	398	203	188
Popullata (në 000)	1.738	1.859	1.948	1.991

2.2. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore

Më 13 Qershor 2002 u themelua Agjensia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) për të administruar dhe ristrukturuar Ndërmarrjet Publike dhe për të privatizuar ato shoqërore. Ndërsa, politikat dhe procedurat e AKM-së u aprovuan më 25 shkurt 2003, duke përcaktuar për menaxhmentin dhe stafin e AKM-së "rregullat e angazhimit" për veprim. Më aprovimin edhe të Rregullores për Shfrytëzimin e Tokës nga Kombet e Bashkuara, 9 maj, u krijuan kushtet për fillimin e procesit të privatizimit të 158 ndërmarrjeve shoqërore. Ishte arritur marrëveshja me Kombet e Bashkuara për t'u dhënë punëtorëve 20 % nga vlera e shitur e ndërmarrjeve shoqërore.

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore filloi më 15 maj 2003 për privatizimin e gjashtë ndërmarrjeve dhe u bllokua pas raundit të dytë të privatizimit të 18 ndërmarrjeve tjera. "Raundi i tretë i privatizimit që përbëhej nga 14 ndërmarrje tjera u publikua, por u anulua sipas instruksioneve të zëvendësit të PSSP-së Shtylla e Besë (Shtylla e IV)". Gjatë vitit 2003 procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore përfundoi më privatizimin e 23 ndërmarrjeve në shumën e paguar prej 26.240.123 euro:

2. Vështrim i përgjithshëm i Ekonomisë Kosovare

Proçesi i privatizimit

Raundi (Tenderi)	Numri i ndërmarrjeve të privatizuara	Shuma e paguar për privatizim (Eur.)
i parë	5	2.335.875
i dytë	18	23.904.247
Gjithsej:	23	26.240.122

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore u ndërpre deri në marrëveshjen e re për plotësimin dhe ndryshimin e procedurave dhe rregullave ekzistuese, lidhur më pranimin apo mospranimin e procedurës së privatizimit pas vitit 1989 me ligjet diskriminuese të Serbisë dhe marrjen e borxheve të ndërmarrjeve shoqërore nga ana e blerësit të ndërmarrjeve shoqërore, si dhe problemeve tjera.

Ngadalësimi dhe ndërprerja e procesit të privatizimit ndikoi në rënien e aktivitetit ekonomik dhe zvogëlimin e interesimit të investitorëve të vendit edhe të huaj për investime në lëmitë e ndryshme të ekonomisë.

2.3. Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore u realizuan në vitin 2003 në shumë prej 608 milion euro, përkatësisht më tepër për 4,1% në krahasim me projektimin e tyre (584,4 mil. euro)⁴⁾.

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore kanë shënuar rritje prej vitit në vit, që nga viti 2000 dhe në fund të vitit 2003 janë rritur për 19,6% më shumë se në vitin 2002.

Për herë të parë, në vitin 2003, të ardhurat e përgjithshme buxhetore janë realizuar tërësisht nga të hyrat vendore: dogana, TVSH, tatimi i paragjykuar, tatimi në fitim dhe taksat tjera. Është karakteristike se 70 % e të gjitha të hyrave tatimore grumbullohen në kufi për shkak të importit të lartë.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore të parashikuara arrijnë shumën në 533 mil. euro dhe suficiti i treguar nga ana e Ministrisë për financa dhe ekonomi është 75 mil. euro. Mirëpo, meqë gjatë vitit 2003 nuk janë shfrytëzuar mjetet e projektuara për disa projekte, suficiti i realizuar buxhetor është 332,8 mil. euro.

Rritja e vazhdueshme e të ardhurave të përgjithshme buxhetore është edhe rezultat e një politike tatimore efikase që mbështetet në kornizën e mirë legjislative për grumbullimin e TVSH-së, detyrimeve doganore dhe të hyrave nga taksat tjera, e që bazohet edhe në praktikat e mira ndërkombëtare. Mirëpo, nëse krahasojmë ngarkesën e GDP me të ardhura buxhetore vërejmë se GDP në Kosovë është ndër më të ngarkuarit në rajon. Kosova e ka të

Banka Ekonomike, Prishtinë

ngarkuar GDP me 35,9 %, ndërsa Bullgaria më 40 %. Ndërsa, Shqipëria ngarkesën më të ultë me 23%.

2.4. Inflacioni

Gjatë vitit 2003 inflacioni shënoi rritje të ulët në krahasim me vendet në region për shkak se kërkesa për konsum dhe shërbime të ndryshme ishte shumë më e vogël se oferta, si rezultat i zhvillimit të ngadalsuar ekonomik dhe rënies së standardit të punëtorëve me rritje të vazhdueshme të papunësisë.

Çmimet me pakicë u rriten në dhjetor të vitit 2003 për 1,6% në krahasim me dhjetorin e vitit paraprak, përkatësisht në krahasim me majin e vitit 2002 shënuan rritje për 3,7%.

Rritja e inflacionit ishte më tepër rezultat i inflacionit të importuar, për shkak të importit shumë të lartë të mallrave dhe shërbimeve.

2.5. Tregëtia e jashtme

Në fund të vitit 2003 u shënuan aktivitete më të mëdha në import se në eksport. Eksporti u rrit prej 27,3 mil. euro në dhjetor të vitit 2002 në 36 mil.euro në dhjetor të vitit 2003, me tendencë të rritjes prej vitit në vit. Në krahasim me vitin 2002, ishte më i lartë për 31,9%.

Importi arriti shumën në 968,5 mil. euro dhe ishte më i lartë se në vitin 2001 për 10,8% ndërsa më i ultë se në vitin 2002 për 2,1%.

Partnerët kryesor tregtarë të eksporteve ishin Unioni Evropian dhe Zvicra (39%), Maqedonia (19,4%), Serbia (16,4%), BH dhe Kroacia (7,5%) dhe Shqipëria (5,3%). Këto shtete merrnin pjesë më 87,6% në shumën e përgjithshme të eksportit.

Partnerët kryesor tregtarë të importeve në vitin 2003 ishin: UE dhe Zvicra (25,9%), Serbia (14,7%), Maqedonia (14,6%), Turqia (9,5%), BH dhe Kroacia (5,6%) dhe Bullgaria (4,3%). Këto shtete merrnin pjesë më 74,6% në shumën e përgjithshme të importit.

Zhvillimet në tregtinë me jashtë në fund të vitit 2003, rezultuan me këtë strukturë të eksporteve dhe importeve kryesore:

a)	Eksportet kryesore:	
·	metalet dhe mbeturinat	41,4 %
·	plastika dhe druri	24,4 %
·	ushqimi	19,4 %
	Gjithsej:	85,2 %

b)	Importet kryesore	
·	ushqimi	34,1 %
·	kemikalje dhe druri	15,8 %

2. Vështrim i përgjithshëm i Ekonomisë Kosovare

·	petrol	14,3 %
·	makineri	12,7 %
·	materiale për ndërtim	6,3 %
·	metale	6,2 %
Gjithsej:		89,4 %

Ekonomia e Kosovës është e varur nga importi dhe vazhdon të ketë deficit të lartë tregtar në shumë prej 932,5 mil. euro, përkatësisht importi është i mbuluar me eksport vetëm më 3,7%. Deficiti tregtar është në rritje prej vitit në vit që nga viti 2000, me përjashtim në vitin 2003 me rënie të vogël:

·	në vitin 2000	- 616,3 mil. euro
·	në vitin 2001	- 863,8 mil. euro
·	në vitin 2002	- 961,4 mil. euro
·	në vitin 2003	- 932,5 mil. euro

Gjatë vitit 2003 ka filluar zbatimi i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Shqipërinë që paraqet një hap pozitiv në rritjen e tregtisë së jashtme.

2.6. Punësimi

Niveli i ultë i zhvillimit ekonomik të Kosovës ka rezultuar me rritjen e vazhdueshme të papunësisë që nga viti 2000:

Periudha	Numri i të papunëve	Edukimi			
		Femra %	Elementar %	Sekondar %	Universitar %
2000	208.074	43,2	58,1	38,8	3,1
2001	237.958	44,1	60,4	37,0	2,6
2002	257.505	44,5	61,5	36,2	2,2
2003	282.305	45,4	63,0	35,3	1,7

Numri i të papunëve është rritur prej 208.074 në vitin 2000, në 282.305 në vitin 2003, përkatësisht për 35,6%, me pjesëmarrje në popullsinë aktive deri në 60% dhe ndër më të lartën në rajon, Ballkan dhe Evropë.

Të punësuarit kryesisht janë në tregti dhe në sektorin publik me mesataren e pagave 130-180 euro.

2.7. Sistemi bankar dhe financat

Me miratimin e Rregullorës së UNMIK-ut për Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës "BPK" dhe Rregullorës për Licencimin, Mbikqyrjen dhe Rregullimin e Bankave në vitin 1999 u krijuan kushtet për licencimin e bankave të nivelit të parë me kapital minimal akcionar 1.000.000 DM dhe

Banka Ekonomike, Prishtinë

nivelit të dytë me 3.000.000 DM.

Banka e parë komerciale u themelua në fillim të vitit 2000 (MEB) dhe të tjerat gjatë vitit 2001 (BrK, BpB, BE, BaK, BkP dhe KsB). Kështu, në fund të vitit 2001 u krijua një sistem i qendrueshëm bankar në Kosovë me 7 banka komerciale të nivelit të dytë me seli në Prishtinë.

Të gjitha bankat komerciale i hapen degët (filialat) dhe nëndegët në tërë Kosovën për të rumbullaksuar sistemin bankar në fund të vitit 2003 me 7 banka komerciale, 40 degë dhe 100 nëndegë.

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës është ende e drejtë e rezervuar e UNMIK-ut dhe nuk i ka të gjitha autorizimet e një banke qendrore.

Depozitat dhe kreditë e bankave komerciale në Kosovë shënuan rritje të vazhdueshme prej vitit në vit, që nga viti 2000:

në 000 Eur.

Struktura	2000	2001	2002	2003
Depozita	93.003	492.255	427.194	515.796
Kredi	3.148	25.916	86.498	232.773
Fitimi neto	3.852	6.716	2.716	6.801

Depozitat shënuan rritjen më të lartë në vitin 2001, duke u rritur për 429,2% në krahasim me vitin 2000, për shkak të konvertimit të DM në valutën e re Eur. Përsonat juridikë dhe fizikë ishin të detyruar që t'i deponojmë DM në llogari bankare deri më 31 dhjetor 2001 për t'i konvertuar në Eur pa pagesë të kompenzimit. Gjatë vitit 2002 ka pasur tërheqje të depozitave dhe depozitat në fund të vitit shënuan rënie për 13,2%.

Ndërsa, gjatë vitit 2003 u rrit besimi i klientëve në banka komerciale si rezultat i likuiditetit të qendrueshëm bankar dhe depozitat u rriten në fund të vitit 2003 për 20,7% në krahasim me vitin e kaluar.

Struktura e depozitave të bankave në fund të vitit 2003, me rritjen e vazhdueshme të pjesëmarrjes së depozitave me afat, tregon krijimin e kushteve për një politikë më stabile kreditore:

- llogaritë rrjedhëse 316 mil. Eur
- depozita me afat 200 mil. Eur

Gjatë periudhës katërvjeçare të ekzistimit të bankave të reja komerciale në Kosovë, kreditë më së shumti u rritën në fund të vitit 2003 për 169,1% në krahasim me vitin e kaluar dhe për 8 herë në krahasim me vitin 2001.

Rritja e lartë e kredive rezultoi për shkak të përkrahjes më të madhe financiare të aktiviteteve ekonomike, me qëllim të ngritjes së nivelit të zhvillimit ekonomik.

Në fund të vitit 2003, pjesëmarrja e kredive në shumën e depozitave arriti në 45,1% dhe ka mundësi të rritet deri në 70%, nëse krijohen kushtet ligjore për sigurimin e kthimit me kohë të kredive me interes, si në perëndim.

2. Vështrim i përgjithshëm i Ekonomisë Kosovare

Kreditë në vitin 2003 u shfrytëzuan kryesisht nga sektori privat me këtë strukturë brenda ekonomisë:

· tregti	113.531.000 Euro	ose	48,8%
· shërbime			
· turizëm etj.	71.606.000 Euro	ose	30,8%
· industri	16.241.000 Euro	ose	7,0%
· bujqësi	4.558.000 Euro	ose	1,9%
· tjera	26.837.000 Euro	ose	11,5%
Gjithsej:	232.773.000 Euro		100,0%

Në strukturën e ekonomisë shfrytëzim më të ultë të kredisë pati bujqësia, edhe pse ka resurse për një zhvillim shumë më të lartë. Në të ardhmën duhet të shihet mundësia e stimulimit të bujqësisë me kredi me afat më të gjatë, normë më të ultë të interesit dhe me politikë fiskale. Ndërsa, shfrytëzimi i ulët i kredive në industri rezultoi me mosinteresimin e investitorëve të vendit dhe të huaj për shkak të bllokimit të procesit të privatizimit dhe moszgjidhjes së statusit të Kosovës.

Kreditë u shfrytëzuan, kryesisht me afat deri në një vit për shkak të strukturës së depozitave me afat, më së shumti deri në një vit. Pati edhe shfrytëzim të vogël të kredive me afat 24 e 36 ëmuaj. Ndryshimi i strukturës afatore të depozitave me afat do të krijoj kushte për lejimin e kredive me afat më të gjatë se një vit.

Fitimi neto shënoi rritje, përveq në vitin 2002 që ishte më i vogël se në vitet tjerë, për shkak se një bankë realizoi humbje.

Moskrijimi i kushteve për zbatimin në tërësi të Rregullores mbi hipotekën dhe mosefikasiteti i sistemit gjyqësor ndikoi në normën e pasigurisë së bankave për orientimin më të lartë të mjeteve të lira në kreditimin e ekonomisë dhe popullatës. Mjetet e lira përkohësisht janë plasuar në bankat korrespondente me normë të ultë të interesit.

Kapitali financiar i pashfrytëzuar në fund të vitit 2003, ishte:
në mil. euro

· llogaritë rrjedhëse		316,0
· depozita në bankat korrespondente		225,8
· suficiti i buxhetit		332,8
· Trusti i Pensioneve		45,0
· fondi i AKM-së		26,2
	Gjithsej:	945,8
· kreditë e bankave	-	232,8
	Gjithsej:	713,0

Banka Ekonomike, Prishtinë

Nga kjo shumë e mjeteve të lira, mjetet e suficitit të buxhetit, Trustit të Pensioneve dhe Fondi i AKM-së ishin jashtë sistemit bankar për shkak se:

- suficiti i buxhetit rezultoi për nga mosrealizimi i projekteve të caktuara brenda vitit buxhetor,
- Trusti i Pensioneve konsideron se bankat komerciale janë më pak të sigurta se ato jashtë Kosovës, dhe
- Fondi i AKM-së nuk është shfrytëzuar si rezultat i vështirësive të paraqitura në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

3. Vështrim mbi Bankën Ekonomike gjatë vitit 2003


Banka Ekonomike e përfundoi vitin 2003 me një shumë aktivesh prej 26,3 milion euro dhe me shumën e përgjithshme të Bilansit prej 27,7 milion euro, duke përfshirë zërat jashtëbilansor. Në krahasim me vitin e kaluar, shuma e përgjithshme e aktivës ishte më e lartë për 65,8% dhe shuma e bilansit për 65,3%.

Fitimi i përgjithshëm neto për vitin 2003 ishte 507.771 euro dhe në krahasim me vitin e kaluar ishte më i lartë për 377%, përkatësisht për 401.334 euro.

Norma e dividendës, duke venë fitimin neto në raport me kapitalin aksionar të angazhuar gjatë vitit 2003, në shumë 2.539 mijë euro, ishte 20%.

Banka Ekonomike në fund të vitit 2003 tejkaloi edhe parashikimet e Planit për këtë vit, duke realizuar këto ecuri kryesore:

- rritjen e depozitave në vlerë 21,5 mil euro, në vend të 19 mil. euro, ose më shumë për 13,5%,
- rritjen e kredive në vlerë 12,4 mil.euro, në vend të 10,5 mil.euro, ose më shumë për 18,1%, dhe
- fitimin neto më shumë për 60,7%.




3.1. Numri i llogarive të klientëve

Numri i llogarive të klientëve të Bankës është rritur prej 1.296 në fund të vitit 2001, në 13.744 në fund të vitit 2002 dhe në 19.249 në fund të vitit 2003, me këtë strukturë:

Banka Ekonomike, Prishtinë

	2001	2002	2003
Person juridik	167	1.042	1.660
Person individual	1.129	12.702	17.589

Numri i përgjithshëm i llogarive të klientëve në fund të vitit 2003 ka shënuar rritje për 40% ose për 5.505 në krahasim me vitin e kaluar.



Llogaritë e hapura në Bankën Ekonomike i përkasin personave juridikë dhe individualë, vendas dhe të huaj. Kryesisht janë të personave vendas. Në kuadër të llogarive të personave individualë, shumica e llogarive i përkasin llogarive për pagesën e pagave dhe pensioneve (14.039 në fund të vitit 2003).

3.2. Depozitat


Depozitat e përgjithshme (llogaritë rrjedhëse dhe me afat) shënuan rritje në fund të vitit 2003 për 65,8% në krahasim me vitin e kaluar dhe për 130,7% në krahasim me 7 mujorin e punës në vitin 2001. Në shumën e përgjithshme të depozitave prej 21.558 mijë euro, depozitat me afat merrnin pjesë me 12.777 mijë euro në fund të vitit 2003, ose me 59,3% që paraqet tendencën e stabilizimit të tyre dhe krijimit të kushteve për një politikë stabile kreditore.

Rritja e depozitave ndikoi në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në shumën e përgjithshme të depozitave në nivel të bankave komerciale në Kosovë, nga 3,1% në vitin 2002, në 4,1% në vitin 2003.

Me Planin e biznesit të Bankës Ekonomike për periudhën 2004-2006, është parashikuar rritja e pjesëmarrjes në depozitat e bankave në 7,1 % në vitin

3. Vështrim mbi Bankën Ekonomike gjatë vitit 2003

2004, në 8,7 % në vitin 2005 dhe në 10,2 % në vitin 2006. Rritja më e lartë është parashikuar e depozitave me afat prej 6,4 % në vitin 2003, në 15% në fund të vitit 2006.




3.3. Kreditimi

Shuma e përgjithshme e kredive u rrit prej 5.793 mijë euro në vitin 2002, në 12.403 mijë euro në fund të vitit 2003, përkatësisht për 114%. Që nga qershori i vitit 2001 e deri në fund të vitit 2003 u lejuan 2.308 kredi në shumë prej 42.538.083 euro, ndërsa janë në shfrytëzim 1.335 kredi në shumë prej 12.403.595 euro, me këtë strukturë:

në 000 Eur

Të lejuara						Në shfrytëzim					
Ndërmarrjeve		Konsumuese		Gjithsej		Ndërmarrjeve		Konsumuese		Gjithsej	
Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma
1.274	41.623	1.034	915	2.308	42.538	514	11.887	821	516	1.335	12.403

Kreditë më së shumti u shfrytëzuan nga ndërmarrjet e lëmive të ndryshme.



Shfrytëzimi i kredive sipas sektorëve, së bashku me garancionet dhe letërkreditë, në fund të vitit 2003, ishte:

		<u>në 000 Eur</u>	
· tregti	9.157 ose	71,5%	
· shërbime, turizmi			
· hoteleria	1.557 ose	12,2%	
· bujqësi	138 ose	1,1%	
· tjerët	1.930 ose	15,2%	
Gjithsej:	12.793	100,0%	

Kreditë më së shumti u shfrytëzuan nga tregtia, për shkak të mosstimulimit të bujqësisë dhe industrisë me masa të Politikës fiskale dhe të tjera. Procesi i kreditimit nga ana e Bankës ishte i kujdesshëm duke patur parasysh nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe rënien e aftësisë kreditore të huamarrësve. Përkundër kësaj, gjatë vitit 2003 u vështërsua afarizmi i disa huamarrësve, të cilët filluan të mos i paguajnë kreditë dhe Banka u detyrua të ngrehë padi gjyqësore në bazë të hipotekës në pasurinë e patundshme, e më pak në bazë të pengut. Janë paditur 28 huamarrës në shumë prej 275.791 euro. Procesi gjyqësor është i ngadalësuar por shpresohet në suksesin e tij. Disa huamarrës të paditur kanë filluar pagesën e borxhit.

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në shumën e përgjithshme të kredive të bankave komerciale në Kosovë arrinë në fund të vitit 2003 në 6,5%.

Me Planin e biznesit për periudhën 2004-2006 është parashikuar rritja e pjesëmarrjes në 8,6% në vitin 2004, në 9,4% në vitin 2005 dhe në 10,2% në vitin 2006.

3.4. Qarkullimi i pagesave

Gjatë periudhës mars-shtator 2002 është bartur qarkullimi i pagesave të brendshme (dogana, tatimet, të hyrat juridike, pensionet etj.) nga BPK-ja në banka komerciale dhe Banka Ekonomike ka shtuar vëllimin dhe strukturën e qarkullimit të pagesave të brendshme në vitin 2003.

Shuma e qarkullimit të pagesave të brendshme midis bankave komerciale nëpërmes BPK-së (kliringu) është në rritje dhe në fund të vitit 2003 arrinë në 96,7 milion euro.

Qarkullimi i pagesave me botën (transferta e mjeteve nga jashtë dhe jashtë vendit) në vitin 2003 është kryer në shumë prej 91,9 milion euro nëpërmes tri bankave korrespondente:

- LHB Internacionale Handelsbank, Frankfurt;
- BASH Banka Amerikane e Shqipërisë, Tiranë;
- RZB Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG, Vjenë.

Transferta e mjeteve jashtë vendit bëhet në mënyrë të shpejtë me anë të bartjes elektronike (LHB - sistemi multikesh, RZB - me internet, BASH - bartje automatike me sistemin ON LINE). Në kuadër të shteteve evropiane është bërë brenda 24 orëve, kurse për shtetet jashtë Evropës brenda 48 orëve.

Vlen të theksohet se transfera e mjeteve nëpërmes të BASH bëhet menjëherë, brenda disa minutave.

Pjesëmarrja e Bankës në shumën e përgjithshme të transfertës hyrëse të mjeteve në nivel të bankave komerciale në Kosovë, në fund të vitit 2003 arrin në 3,1%, ndërsa e transfertës dalëse të mjeteve arrinë në 6,2%.

Me Planin e biznesit për periudhën 2004-2006 është parashikuar rritja e vazhdueshme e pjesëmarrjes së Bankës në bilansin e pagesave të Kosovës:

	<u>2004</u>	<u>2005</u>	<u>2006</u>
Eksportet	5,0 %	7,0 %	10 %
Importet	10,0%	12,0%	14 %

Banka ka të instaluar sistemin ON-LINE me të gjitha degët që mundëson kryerjen e menjëhershme të shërbimeve të klientëve, pavarësisht se në cilën degë të Bankës e kanë të hapur llogarinë bankare.

Shërbimet e qarkullimit të pagesave në llogarin e klientit dhe midis klientëve në tërë rrjetin e degëve të Bankës bëhen gratis.

Banka i stimulon klientët për shërbimet e transfertës së mjeteve në valuta tjera jashtë vendit pa komision për konvertim të euros në valuta tjera.

3.5. Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat e përgjithshme u rritën prej 1,3 mil.euro në vitin 2002 në 2,5

Banka Ekonomike, Prishtinë

mil.euro në fund të vitit 2003, përkatësisht për 90,3%.

Në strukturën e të ardhurave të përgjithshme, pjesëmarrje më të lartë kanë:

· të ardhurat nga interesat në kreditë e dhëna	53,0 %
· komisioni për kreditë e dhëna	14,6 %
· komisioni nga transferta e mjeteve jashtë vendi dhe për garanci e L/C	11,1 %
· të tjerat	21,3 %

Të ardhurat nga interesat në kreditë e dhëna së bashku me të ardhurat nga institucionet financiare vendase dhe të huaja arritën shumën prej 1.493 mijë euro dhe në krahasim me vitin e kaluar janë rritur për 121,2%. Nëse këto të ardhura i zvogëlojmë për shpenzimet e interesit në depozita me afat (301), të ardhurat neto nga interesat janë realizuar në shumën prej 1.192 mijë euro dhe në krahasim me vitin e kaluar shënojnë rritje prej 113,2%.

Shpenzimet e përgjithshme kapin shumën prej 2,1 milion euro në fund të vitit 2003 dhe u rritën për 78,3% në krahasim me vitin e kaluar, por më pak se të ardhurat për 12,0%.

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme, pjesëmarrje më të lartë kanë:

· të ardhurat personale	26,8 %
· interesi në depozita me afat	14,8 %
· rezervimet për kreditë e lejuara	17,2 %
· qiratë	8,3 %
· amortizimi i mjeteve themelore	7,2 %
· tatimi në fitim	6,3 %
· tjera	19,4 %

Rritja më e ngadalshme e shpenzimeve të përgjithshme në krahasim me rritjen e të ardhurave rezultoi me realizimin e fitimit neto në shumë prej 507.771 euro, që është më i lartë për 161,1% në krahasim me vitin e kaluar. Banka pagoi tatimin në fitim në shumë prej 129.450 euro, përkatësisht 20% në fitimin bruto për vitin 2003.

Treguesit kryesorë

Raporti i fitimit neto mbi aktivet (ROA)	1,92 %
Raporti i fitimit neto mbi aktivet me risk (RORA)	3,32 %
Raporti i fitimit neto mbi kapitalin në fund të vitit (ROE)	13,0 %
Raporti i fitimit neto mbi kapitalin në funksion gjatë vitit (ROE)	20,0 %
Raporti i kapitalit (klasa 1) mbi aktivet	16,8 %
Shpenzimet e përgjithshme në raport me të ardhurat e përgjithshme	80,0 %

3.6. Zgjerimi

Banka Ekonomike që nga licencimi dhe rifillimi i punës në qershor të vitit

3. Vështrim mbi Bankën Ekonomike *gjatë vitit 2003*

2001 e deri në fund të vitit 2003 hapi 7 degë (filiala), 1 nëndegë dhe 7 zyre në tërë Kosovën dhe rumbullaksoi rrjetin e degëve për kryerjen më me sukses të shërbimeve bankare.

Hapja e degëve është bërë në këto periudha kohore:

- Banka me degën në Prishtinë në maj të vitit 2001
- Dega në Gjakovë në tetor të vitit 2001
- Dega në Pejë në dhjetor të vitit 2001
- Dega në Prizren në mars të vitit 2002
- Dega në Ferizaj në tetor të vitit 2002
- Dega në Mitrovicë në nëntor të vitit 2003
- Dega në Gjilan në fund të vitit 2003

Ekspozitura është hapur në Burim (Istog) në qershor të vitit 2002, ndërsa zyret janë hapur kryesisht në pikat doganore dhe regjistrimit të automjeteve. Me zgjerimin e rrjetit të Bankës janë krijuar kushtet për rritjen e shërbimeve bankare: depozitat, kreditë për kompani dhe individuale, qarkullimi i pagesave të ndryshme dhe shërbimet tjera bankare.

PASQYRAT FINANCIARE

PËR FUNDIN E VITIT ME 31 DHJETOR 2003 DHE 2002

SË BASHKU ME RAPORTIN E AUDITORËVE TË PAVARUR



Raporti i Auditorëve të Pavarur

Aksionarëve të Bankës Ekonomike, sh.a. Prishtina,

Ne kemi audituar paqyrat financiare të Bankës Ekonomike sh.a. Prishtina me 31 Dhjetor 2003 dhe 31 Dhjetor 2002 (Banka), si dhe pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndryshimet në kapitalin e aksionarëve dhe pasqyrën a rrjedhës së parasë për vitin që perfundon me 31 Dhjetor 2003 dhe 31 Dhjetor 2002. Keto pasqyra financiare janë pergatitur nën përgjegjesinë e drejtuesve të Bankës. Përgjegjësia jonë është të japim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë.

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të planifikojmë dhe zbatojmë auditimin për të dhënë një siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare mos të përmbajnë gabime materiale. Auditimi, bazuar në kryerjen e testeve, ka të bëjë me ekzaminimin e dokumenteve në mbështetje të shifrave dhe informacioneve tjera të paraqitura në pasqyrat financiare. Auditimi, gjithashtu vlereson parimet kontabël të përdorura dhe parashikimet e bëra nga drejtuesit, si dhe jep një vlerësim mbi paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë që auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për dhënien e opinionit.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Bankës më 31 Dhjetor 2003 dhe 2002 dhe rezultatet operative sikurse: ndryshimet në kapitalin e aksionarëve, dhe rrjedha e parasë për vitin që perfundon me 31 Dhjetor 2003 dhe 2002 janë në përputhje me Standartet Nderkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte & Touche,
Prishtinë

15 Shkurt 2004

Banka Ekonomike, Prishtinë

	Shenimi nr	31 dhjetor, 2003 (in EUR 000)	December 31dhjetor , 2002 (in EUR 000)
ASETET			
Para ne dore dhe ne banka	3	8,336	7,791
Balanca me Autoritetin Bankar te Pagesave te Kosoves	4	4,943	1,679
Hua ndaj klienteve, neto	5	12,288	5,717
Interesa akruale dhe llogari te tjera te arketueshme	6	52	80
Aktive fikse te qendrueshme	7	643	474
Aktive te paqendrueshme	8	73	81
Total asetet		26,335	15,822
DETYRIMET			
Detyrime ndaj klienteve	9	21,561	13,053
Interesi akruar dhe detyrime tjera	10	354	124
Total detyrimet		21,915	13,177
KAPITALI			
Kapitali I aksionareve	11	3,912	2,539
Fitimi I mbajtur	12	508	106
Total kapitali a aksionareve		4,420	2,645
TOTAL DETURIMET DHE EKUITETI I AKSIONAREVE		26,335	15,822

Autorizuar për tu lëshuar nga drejtuesit më 15 Shkurt 2004:

Z. Hajrullah Zaiti
Drejtor Ekzekutiv

Znj. Syzana Kacaniku
Drejtoreshë Financiare

	Sheni mi no.	Per fundin e vitit 31 Dhjetor 2003 (ne EUR 000)	Per periudhen deri me 31 Dhjetor 2002 (ne EUR 000)
Te ardhura nga interesat		1,493	675
Shpenzime interesi		(301)	(116)
TE ARDHURA NETO NGA INTERESAT	13	1,192	559
Te ardhura nga tarifat dhe komisionet		1,028	634
Shpenzime per tarifa dhe komisione		(80)	(72)
TE ARDHURA NETO NGA TARIFAT DHE KOMISIONET		948	562
Te ardhura te tjera operuese	14	21	26
TOTALI I TE ARDHURAVE		2,161	1,147
Shpenzime te tjera operuese	15	(1,174)	(740)
Shpenzime neto per provizione per borxhe te dyshimta	5	(350)	(165)
TOTALI I SHPENZIMEVE		(1,524)	(905)
FITIMI/(HUMBJA) NETO PARA TATIMIT		637	242
Tatimi	16	(129)	(52)
FITIMI/(HUMBJA) NETO		508	190

	Kapitali aksioner (neEUR 000)	Fitimi i pashperdarë (humbja e akumuluar) (ne EUR 000)	Totali i kapitalit (ne EUR 000)
Gjendja me 1 Janar 2002	1,545	(84)	1,461
Rritje nga emetimi i aksioneve	994	-	994
Fitimi neto i vitit	-	190	190
Gjendja me 31 Dhjetor 2002	2,539	106	2,645
Rritja e kapitalit nga shperndarja e dividentave	106	(106)	-
Rritja e kapitalit kontributet ne kesh	1,267	-	1,267
Profiti neto i vitit	-	508	508
Gjendja me 31 Dhjetor 2003	3,912	508	4,420

Banka Ekonomike, Prishtinë

	Notes	Për fundin e vitit 31 Dhjetor, 2003 (in EUR 000)	Për fundin e vitit 31 Dhjetor, 2002 (in EUR 000)
Rritja e parase nga aktivitetet operative			
Fitimi/(humbja) neto i periudhes para tatimit		637	242
Axhustime per:			
Amortizimi	7, 8	147	110
Provizioni per borxhe te dyshimta	5	350	165
Humba nga nxjerrja jashte perdorimi i asetëve .	16	5	
Fitimipara ndryshimeve te aktiveve dhe pasiveve operative		1,139	517
Rritje e huave ndaj klienteve, neto		(6,921)	(4,745)
Zvogelimi/(rritje) e interesave akruale dhe llogarive te tjera te arketueshme		17	(62)
Rritje ne parate ne arke dhe ne banka		(725)	(45)
Rritje ne detyrimet ndaj klienteve		8,508	3,712
Rritje ne interesat akruale dhe detyrime te tjera		198	72
Shuma neto e parave gjeneruara (te perdorura) nga aktivitetet operative		2,216	(551)
Tatimi i paragjykuar i paguar		-	(13)
Tatimi ne fitim i paguar		(86)	(12)
Shuma neto e parave (te perdorura) gjeneruara nga aktivitetet operative		2,130	(576)
Rrjedhje e parase nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve te qendrueshme fikse	7	(302)	(291)
Blerje e aktiveve te paqendrueshme	8	(11)	(48)
Para neto te perdorura ne aktivitetet investuese		(313)	(339)
Rrjedhje e parase nga aktivitetet financiare			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner		1,267	963
Rrjedhje e parase nga aktivitetet financiare		1,267	963
Rritje neto e parave dhe ekuivalenteve te tjere		3,084	48
Gjendja e parave dhe ekuivalenteve te tjere ne fillim te periudhes		9,425	9,377
Gjendja e parave dhe ekuivalenteve te tjere ne fund te periudhes		12,509	9,425
Gjendja e paravedhe ekuivalenteve te tjere ne fund te peruidhes eshte e perbere si me poshte:			
Para ne dore dhe ne banke te pakufizuara			
Balanca me Autoritetin Bankar te Pagesave te Kosoves	3	7,566	7,746
Totali	4	4,943	1,679
Total		12,509	9,425

1. Të Përgjithshme

Në përputhje me rregullat e Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK), Banka ka fituar licensën për ushtrimin e aktiviteteve bankare më 28 Maj 2001 dhe filloi aktivitetet më 5 Qershor 2001. Zyra qendrore e Bankës ndodhet në Rr. Qafa nr. 4, Prishtinë, Kosovë.

Banka operon si një bankë kursimi dhe komerciale për të gjitha kategoritë e klientëve, nëpërmjet rrjetit të vet prej 6 degëve në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Mitrovicë prej të cilave degët në Prizren dhe Ferizaj janë hapur gjatë vitit 2002, dhe dega në Mitrovicë në vitin 2003.

